



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:297432

Datë: 10.02.2022

Numri i dokumentit: 02701523

E.nr.1004/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorës S.Q., të cilën e përfaqëson av Islam Gashi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 10.02.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.1004/21**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1004/21, të datës 15.09.2021, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor C.nr.1572/19, të datës 20.08.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 08.11.2021, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,998 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1004/21, më datë 10.02.2022

GJYQTARI
Faton Ajvazi